



Republika e Kosovës

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

01 Nr. 246/25 Dt. 15.04.2025

Komuna e Prizrenit

Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja g të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, të nenit 8 dhe 19 të Rregullores Komunale nr. 001-011-201 datë 03.01.2024 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve pas kërkesës së Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave

- Formohet dhe emërohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave të parashtruar ndaj listës së përfituesve të bursave komunale të publikuara nga ana e Komisionit që ka bërë shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave (aplikacioneve) dhe ndarjen e bursave për studentët, për vitin akademik 2024/2025. Anëtarë të këtij Komisioni emërohen:
 - Islam Osmankaj,
 - Haxhere Gavazaj,
 - Nezir Osmani.
- Komisioni i përberë si në pikën 1 të këtij Vendimi, në mbledhjen e tij të parë do të zgjedhë kryesuesin e komisionit.
- Komisioni, nga pika 1 e këtij Vendimi, do t'i ushtrojë detyrat dhe përgjegjësitë e veta në pajtim me konkursin e shpallur për ndarjen e bursave dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi.
- Obligohet Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe të emëruarit e këtij Komisioni për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës,
 - Të emëruarve,
 - Arkivës së Kryetarit.

